



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 31, datë 09. 10. 2012

PËR

**“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 28, DATË 29.09.2008
PËR “MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE
TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, 32 shkronja “ç”, të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000, për “Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”, (i ndryshuar); nenit 113, nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar); ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 për “Rregullat e Etikës në Administratën Publike”; vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 28, datë 29.09.2008 për “Miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Të miratojë ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.28, datë 29.09.2008 për “Miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore”, si më poshtë:
 - a. Në pikën 1 togfjalëshi: “*prej 130 punonjësish*” zvendësohet me togfjalëshin “*prej 139 punonjësish*”.
 - b. Aneksi 1, pjesë përbërëse e vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 28, datë 29.09.2008 për “Miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore”, zëvendësohet me Aneksin nr. 1 bashkëlidhur pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen Drejtoria e Planifikimit Strategjik, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi në 01.01.2013.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI